



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.03/2018

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Dr. sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Partia Republikane e Kosovës (PRK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit Nr.248/2018, të datës 02.03.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të pezullimit të subjektit politik nga Regjistri i Partive Politike të Regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 08.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik Partia Republikane e Kosovës (PRK) me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër vendimit Nr.248/2018 i datës 02.03.2018, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, me datë 05.03.2018 ka pranuar një apel nga subjekti politik PRK, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me numër protokolli 248/2018 të datës 02.03.2018, me të cilën thekson se KQZ me datën 02.03.2017 ka marre vendimin me nr. 248/2018 për pezullimin e subjektit politik PRK nga regjistri i partive politike për shkak të mos përmbushjes së obligimeve që dalin nga neni 15 i Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, në bazë të të cilit nen subjekti politik në fjalë është dashur që të që të mbajë kuvendin zgjedhor. Parashtruesi i apelit thekson se pas kuvendit të parë zgjedhor u paraqitën disa rrethana që e detyruan PRK-në që të mbajë medoemos edhe dy kuvende të jashtëzakonshme për arsye se është regjistruar edhe një subjekt tjetër politik me emër dhe akronim shumë të ngjashëm.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ, me nr. Protokolli 90/2018 të datës 06.03.2018 theksohet KQZ-ja në mbështetje të nenit 6.1 dhe 15 Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike e ka pezulluar nga regjistri i partive

politike subjektin politik PRK dhe të njëjtën e ka obliguar që në afat prej 45 ditë të mbaj kuvendin e saj pasi që e njëjta nuk e ka informuar KQZ-ne për mbajtjen e kuvendit të saj. E njëjta thekson se vendimi i KQZ-së është marrë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi pasi që kuvendi i subjektit politik PRK është dashur të mbahet me datën 10 Janar 2018 ndërsa rekomandimi për pezullim është dërguar me datën 20.02.2018. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se kryetari i këtij subjekti politik me datën 01.03.2018 përmes emailit ka njoftuar se do të mbaj kuvendin e saj zgjedhor me datën 17 mars 2018

KQZ, në përgjigjen e saj si dëshmi ka bashkangjitur:

- Vendimin e KQZ-së për pezullim
- Njoftimet elektronik lidhur me rekomandimin për pezullim.

Paneli, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka trajtuar si apel duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 02.03.2018 me numër protokolli 248/2018 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ-ZRPPC-së gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

PZAP, konstaton se KQZ-ja me vendimin me Nr.248/2018 të datës 02.03.2018, ka vendosur drejt kur ka bërë pezullimin nga Regjistri i Partive politike subjektin politik Partia Republikane e Kosovës (PRK).

Dispozita e nenit 15.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike ka përcaktuar që *"Partia e regjistruar politike mban kuvendin brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku dyzet e tetë (48) muaj"*.

Paneli konstaton nga shkresat lëndës, se subjekti politik Partia Republikane e Kosovës (PRK), nuk i ka përmbushur obligimet ligjore të cilat parashihen me nenin 15 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013. Po ashtu Paneli ka gjetur se KQZ-ja në pajtim me nenin 6 paragrafi 1, pika (aa), të Rregullës Zgjedhore 01/2013 me vendimin me nr. 248/2017 të datës 02.03.2018 e ka pezulluar nga regjistri i partive politike duke i dhënë afat shtesë subjektit politik në fjalë që në afat të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditësh, nga dita e pezullimit të mbaj kuvendin zgjedhor.

Bazuar në këto që u theksuan më lartë PZAP konstaton se vendimi i KQZ-së me Nr.248-2018 i datës 02.03.2018, për pezullimin e subjektit politik PRK nga regjistri i partive politike është i drejtë dhe i bazuar në nenin 15.1 dhe 6.1 pika a) Rregullës Zgjedhore 01/2013 ngase siç vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës subjekti politik në fjalë nuk i ka përmbushur obligimet ligjore për mbajtjen e kuvendit zgjedhor siç parashihet me nenin 15.1 të Rregullës Zgjedhore 01/2013, gjë për të cilën subjekti politik në fjalë nuk ka arritur që të dëshmojë se ka ndërmarr ndonjë veprim të tillë,

ndërsa të gjitha pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara dhe nuk janë arsye për subjektin politik në fjale për mos përmbushjen e obligimeve që dalin nga Rregulla Zgjedhore 01/20013 pasi që subjekti politik PRK si i tillë ekziston dhe ka për obligim përmbushjen e këtyre detyrimeve ligjore.

Për arsyet e cekura si më lartë e në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 03/2018 më datën 08.03.2018

Kryesuesi i Panelit,

Dr. sc Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.